

PRA KY QËNKA  
**ABUZIMI  
SEKSUAL?**



COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

**A ndjehesh në siklet me mënyrën si ata të shohin dhe të prekin?**

**Po qarkullojnë disa foto nudo?**

**A dyshon se ka një motiv të fshehtë?**

**Nuk ndjehesh e/i sigurt nesë do ta bësh atë gjë?**

**A ka filluar procedimi penal?**

**TI NUK JE I VETMI QË KE  
PYETJE.**

**LEXO HISTORITË E TË  
TJERËVE DHE MËSO PËR  
TË DREJTAT E TUA!**



# JAM E LUMTUR QË MË TREGOVE!



Si je e dashur? Mbrëmë kur erdhe në shtëpi ishe shumë e shqetësuar.

**Nuk kam asgjë...**

Ti zakonisht kur vjen nga takimet je e buzëqeshur.

**Të thashe pra, s'kam gjë!!**

Në rregull. Në rast se ke dëshirë të flasësh, këtu më ke.

**Nuk është ndonjë gjë e madhe; u zumë...**

Zemër, më vjen keq. Po çfarë ndodhi?

**... ai më tha që unë nuk e dua ...**

Por pse mendon ai kështu?

**Nuk e kam idenë... Ose... por... Vetëm se nuk dua që të të ikë mendja.**

Do bëj çështë e mundur :)

**Ne akoma s'kemi... kështu që... Ai thotë që vajzat e tjera në moshën 15 vjeç nuk mendojnë se është ndonjë gjë e madhe të flesh me dikë. Por nuk është se unë po e bëj të madhe këtë gjë!! Por ne vetëm sa jemi lidhur, dhe... unë... kështu që... e ke parasysh.**

E kuptoj. Ti nuk je akoma gati, ose nuk do që të ndodhë tani.

**Ekzaktësisht!**

Përpara herës së parë (ashtu sikurse çdo herë), gjëja më e rëndësishme është të jesh e sigurtë se edhe ti e do këtë gjë dhe se partneri yt do të njëjten gjë si ty.

**Ai më thotë që nëse vërtetë e dua, unë as që duhet të mendohem farë të bëj seks me të.**

E dashur, të duash dikë nuk është e njëjta gjë si të duash të shkosh me të. Këto janë dy ndjenja tërësisht të ndryshme.

**Nuk e kuptoj këtë. Se në fakt, mua më pëlqen vërtet ai ...**

Nëse ju të dy doni që ajo gjë të ndodhë, por ai të ushtron presion emocional, kjo gjë tregon se dëshira e tij është më e rëndësishme për të se sa ndjenjat dhe qëllimet e tua.

**Por unë nuk dua që ta lëndo. Nuk dua që ai të ndahet nga mua...**

Sigurisht zemër. Por kontrolli i dëshirave të tij varet nga ai dhe nëse kjo nuk ndodh, nuk është për fajin tend. Kështu që, nuk je përgjegjëse për ndjesitë dhe veprimet e tij.

**Po kjo mos do të thotë që ai nuk më do mua?!**

Nuk e di, ndoshta ai të do, por dashuria nuk tregohet nëpërmjet dhunës dhe presionit.

**Kjo është shumë e sikletshme...**

Jam shumë e lumtur që e ndave këtë gjë me mua. Gjithashtu, jam shumë krenare që ti je e aftë të thuash jo!

**Prindi**



**TË FLASËSH PËR SEKSUALITETIN, SHPESH ËSHTË E VËSHTIRË. VEÇANËRISHT, NËSE JE DUKE PËRJETUAR NDJENJA SI TURPI, FAJI DHE FRIKA KUR FLET PËR TË**

**TI NUK JE VETËM! NËSE DIKUSH PO TË LËNDON, OSE KE PYETJE, BISEDON ME NJË TË RRITUR TEK I CILI KE BESIM. NDOSHTA ME NJË NGA PRINDËRIT, NJË ANËTAR TË FAMILJES, MËSUES, PSIKOLOG; TEK ÇDO NJERI QË NDJEHESH I/E SIGURTË PËR TË FOLUR DHE AI TË DËGJON.**

**DHËNIA E PËLQIMIT NGA ANA JUJ VARET NGA MOSHA QË KENI : VETËM NJË FËMIJË QË KA ARRITUR MOSHËN LIGJORE PËR AKTIVITET SEKSUAL MUND TË JAPË PËLQIMIN E VLEFSHËM PËR NJË MARRËDHËNIE INTIME.**

**PËR TË KRYER MARRËDHËNIE SEKSUALE DUHET TË JENI TË DY DAKORT, PËRNDRYSHJE KONSIDEROHET DHUNË. ËSHTË ABUZIM NËSE DIKUSH PËRFITON NGA TY KUR TI MUND TË MOS JESH PLOTËSISHT DAKORT, KUR MUND TË JESH E DEHUR OSE E PAVETËDIJSHME DHE RRJEDHIMISHT E PAAFTË PËR TË MARRË VENDIMIN E DUHUR.**

**TË KËRKOSH NDIHMË NUK ËSHTË TURPI!**

**NË RAST SE NUK DI ME KË TË FLASËSH, TI MUND TË TELEFONOSH NJË LINJË FALAS DHE TË FLASËSH ME DIKË QË TË KUPTON DHE TË NDIHMËN NË SITUATËN QË NUK DI SI TË VEPROSH. MË POSHTË KE LINJËN E NDIHMËS**

**LINJA E NDIHMËS SHQIPERI: ALO 116  
[HTTPS://WWW.ALO116.AL/](https://www.alo116.al/)**

# PRA KY MUND

## TË QUHET

### ABUZIM SEKSUAL?



Ju mund të keni dëgjuar se mësuesi i sportit u largua nga shkolla, dhe unë jam këtu për të folur për këtë ngjarje.

#### A është përzënë më të vërtetë nga shkolla?

Unë dëgjova se ai ishte përzënë nga shkolla për shkak se një nga prindërit e akuzoi për abuzim seksual me një vajzë.

Shkolla është përgjegjëse për t'ju mbrojtur nga abuzimi, përfshirë atë seksual. Kjo nënkupton se askush nuk mund t'ju prekë nëse nuk jeni dakord.

#### Pra, ky quhet abuzim seksual?

Jo vetëm. Kini parasysh se nuk është në rregull as për shembull, t'ju bëjnë komente apo oferta që ju bëjnë të ndiheni të poshtëruar.

#### Mirë, por nëse personi e ka keqkuptuar sjelljen?

Në rast se diçka është fyese, veprimi duhet të hetohet, pavarësisht se kush është autori. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme që të rriturit të informohen në lidhje me këtë.

#### Kam dëgjuar se ai kishte fyer edhe një vajzë në dhomën e zhveshjes. Por unë mendoj se ishte vetëm shaka...

Të gjitha format e dhunës janë të ndaluara. Nëse dikush është duke bërë shaka me ju, ose thjesht duke bërë shaka seksuale dhe të turpshme, edhe ky quhet abuzim.

#### Unë mendoj se ai thjesht e pëlqente, kjo është e gjitha. Shoku im tha se ata rrinin shumë bashkë pas trajnimit.

#### Po, edhe unë kam dëgjuar se ata rrinin bashkë.

Edhe në qoftë se një marrëdhënie mes një mësuesi dhe një nxënësi mund të duket si marrëdhënie dashurie, balanca e pushtetit nuk është e barabartë dhe mësuesi është thjesht duke abuzuar me autoritetin e tij mbi nxënësin dhe besimin e nxënësit tek ai.

#### Po nëse ajo kishte rënë dakord?

Kjo nuk ka rëndësi. Çështja qëndron të zgjedhja e lirë dhe e pavarur e nxënësit. Këta nuk mund të bien dakord lirisht sepse mësuesi ka fuqi mbi ta dhe marrëdhënie të tilla janë gjithmonë të ndaluara.

#### Është edhe faji i tyre, nëse abuzimi ndodh ...

Abuzimi seksual NUK është kurrë faji i fëmijës. Në shumicën e rasteve abuzimet nuk janë zbuluar për shkak se fëmija ndihet i turpëruar për atë që ka ndodhur apo është duke fajësuar veten. Abuzimi seksual, forca ose kërcënimet janë gjithmonë një krim.

ABUZIMI SEKSUAL ËSHTË I DËNUESHËM. EDHE NË QOFTË SE AI ËSHTË KRYER NGA NJË PRIND, MËSUES, TRAJNER APO NGA DIKUSH I RËNDËSISHËM, NDAJ SË CILIT/CILËS VARENI. OSE EDHE NGA NJË FËMIJË TJETËR OSE NJE I RI. AI ËSHTË SUBJEKT I RREGULLAVE DHE DËNIMEVE TË RREPTA.

BESONI NË NDJENJAT TUAJA TË KËQIJA LIDHUR ME NJË SITUATË. THUAJINI DIKUJ TË BESONI, NË MËNYRË QË TË MUND TË GJENI ZGJIDHJE, POR DHE PËR T'JU MBAJTUR JU DHE MIQTË TUAJ TË SIGURT.

KONTAKTET INTIME MES MËSUESVE DHE NXËNËSVE QUHEN GJITHMONË ABUZIM. ASHTU SI NË RASTET E TJERA TË ABUZIMIT SEKSUAL, KJO ËSHTË GJITHMONË PËRGJEGJËSI E TË RRITURIT; NXËNËSI NUK ËSHTË FAJTOR.

NËSE DIKUSH JU DETYRON TË ANGAZHoheni NË AKTIVITET SEKSUAL KUNDËR VULLNETIT TUAJ, AI PERSON KRYEN NJË KRIM. ASKUSH NUK MUND T'JU DETYROJË PËR TË TAKUAR, PËRQAFUAR, APO PUTHUR NJË PERSON. ËSHTË GJITHASHTU E DËNUESHME NËSE NJË PERSON PREK Pjesët TUAJA INTIME, JU GODET, OSE JU DETYRON TË SHIKONI FILMA PORNOGRAFIKE. ËSHTË GJITHASHTU E NDALUAR NËSE DIKUSH PREK ORGANET TUAJA GJENITALE KUNDËR VULLNETIT TUAJ, JU DETYRON TË MASTURBOHENI NË PRANINË E TYRE, OSE JU DETYRON QË TË BËNI SEKS ME TA.



Psikolog



# PO NËSE AI KA QËLLIME TË FSHEHTA?



**Përschendetje, unë nuk kam telefonuar kurrë, por kam nevojë për disa këshilla, sepse unë kam një shoqe dhe ... jam pak e shqetësuar rreth saj.**

Përschendetje! Unë jam i/e lumtur që me telefonuat.

**Deri më tani, ajo kishte thënë se ishte gati për të bërë provimin për një kurs dhe tani ajo nuk është pothuajse kurrë në shkollë.**

Ka ndodhur diçka?

**Ajo ka një shokë të ri, një djalë i rritur, ajo takohet me të shpesh.**

A mund të më thuash ndonjë gjë tjetër?

**Ata u takuan në një festë. Në shtëpinë e fëmijës ku ne jetojmë nuk na lejojnë jashtë gjatë natës, por ajo doli fshehurazi. Ajo është lidhur me atë djalë që atë natë dhe nuk flet me mua. Ai vjen për ta marrë me makinën e tij; e dërgon në vende si kinema, nëpër qytet dhe vende të ngjashme.**

Unë e kuptoj se kjo është një situatë e vështirë për ty.

**Ajo ndryshoi krejtësisht. Ajo del rrallë me ne, edhe kur ajo del me ne është krejtësisht e çuditshme, rri e mërçitur për çdo gjë, ajo mendon se mund të bëjë gjithçka.**

Ke folur për këtë me të?

**Ne mezi shohin njëra-tjetrën kohët e fundit. Ajo vetëm me përgjigjet me mesazhe, ajo vepron në mënyrë të çuditshme, dhe kur është në shtëpi ndonjëherë është shumë e lumtur ose me përçafon mua, herë të tjera ajo përplas derën pas saj.**

Është gjë e mirë që ju vendosët për të bërë këtë telefonatë për shkak se shoqja juaj mund të jetë në një marrëdhënie në të cilën ajo gëzon shumë gjëra tani, megjithatë, kjo marrëdhënie mund të jetë e rrezikshme.

**Pse mund të jetë e rrezikshme?**

Ndonjëherë ndodh që të rriturit ndërtojnë një marrëdhënie të ngushtë besimi me fëmijët, duke u dhënë atyre gjëra të veçanta dhe të dashura për ta, por jo sepse ata kanë qëllime të mira, por në mënyrë që të bëjnë fëmijët të bëjnë gjëra që nuk duhet dhe të mos thonë „jo“ për situata që nuk duan.

**Unë nuk e njoh atë djalë, por unë do të çmendem nëse ai e lëndon shoqën time...**

A keni biseduar ndonjëherë për këtë me dike tjetër, me një të rritur? Për shembull, shkolla mund të ketë vënë re se diçka ka ndodhur.

**Ajo do të më urrejë mua, nëse unë flas për këtë me dikë tjetër. Por është e pamundur për të folur me të!**

Ky nuk është faji i saj dhe as i yti, ajo duhet të jetë e mbrojtur nga ky djalë. Nëse ti kërkon ndihmë për të, kjo nuk do të thotë që ti po e tradhton atë; kjo do të thotë që ti po e ndihmon atë.

**Erdhën njerëz. Më duhet të shkoj.**

**KA NJË LINJË TELEFONIKE PA PAGESË DHE ANONIME PËR FËMIJËT. NËSE JU NDIEHENI SE DONI TË NDANI ÇFARË JU SHQETËSON APO NDIHENI TË VETMUAR, MUND TË TELEFONONI LINJËN NDIHMËSE. ATA DO JU DËGJOJNË.**

LINDJA E NDIHMËS EVROPIANE PËR FËMIJË: 116-111. GJEJ LINJËN PËR SHQETËSIMIN TËND KËTU: [HTTPS://WWW.CHILDHELPLINEINTERNATIONAL.ORG/CHILD-HELPLINES/CHILD-HELPLINE-NETWORK/](https://www.childhelplineinternational.org/child-helplines/child-helpline-network/)

**NËSE KENI NJË PARANDJENJË TË KEQE, OSE JU JENI NËN PËRSHTYPIEN SE DIKUSH MUND TË KETË FSHEHUR SYNNIMET ME JU, BISEDONI ME NJË TË RRIUR TEK I CILI KENI BESIM!**

**NËSE DIKUSH PËRDOR FËMIJËT PËR QËLLIME SEKSUALE NË KËMBIM TË DHURATAVE, ALKOOLIT, CIGAREVE, PREMTIMEVE OSE TË HOLLAVE, KJO KONSIDEROHET SHFRYTËZIM DHE MADJE MUND TË JETË PROSTITUCION. KUSHDO QË PËRDOR, BIND APO MANIPULON NJË FËMIJË PËR TË BËRË TË TILLA VEPRIME, KRYEN NJË KRIM. NUK KA RËNDËSI NËSE FËMIJA ËSHTË NË MOSHË PËR TË MIRATUAR MARRËDHËNIEN SEKSUALE, VEPRIMI KONSIDEROHET KRIM PËR NJË TË RRIUR QË JEP DIÇKA NË KËMBIM TË SEKSIT ME NJË FËMIJË.**



Linja për ndihmë

# DUKE SHKUAR NË NJË TAKIM



KUR DIKUSH NDËRTON NJË MARRËDHËNIE DHE BESIM ME FËMIJËT PËR TU ANGAZHUAR NË SEKS OSE PËR TA BËRË MË TË KOLLAJTË KONTAKTIN SEKSUAL, KJO QUHET 'GROOMING'. ËSHTË NJË FORMË E ABUZIMIT SEKSUAL; AJO MUND TË NDODHË SI ONLINE ASHTU EDHE OFFLINE. ATA MUND TË PËRPIQEN TË KRIJOJNË ILUZIONIN E NJË MIQËSIE OSE TË NJË MARRËDHËNIE DASHURIE ME FËMIJËN.

**Përshëndetje, a keni pak kohë?**

Sigurisht. Ç'kemi? U bë kohë pa u parë!

**Epo, po ndodh diçka ... Është ai djali, për të cilin po flasim prej kohësh.**

U takuat online?

**Po. Ai më shkruajti, ne filluam të bisedonim, dhe e di, ai është i shkëlqyeshëm. Ai e kupton plotësisht se çfarë po kaloj. Ai është ngacmuar nga të tjerët njësoj si unë. Përveç kësaj, prindërit e tij e pranuan shumë më lehtë faktin se ai është homoseksual.**

Pra, jeni takuar tashmë?

**Jo, vetëm kaq. Ai nuk është nga këtu, por do vijë këtë fundjavë, dhe dëshiron të takohet.**

Kjo është vërtet gjë e bukur! Çfarë di rreth tij?

**Ai është shumë i vëmendshëm, gjithmonë pyet se çfarë të reje ka nga mua, deri tani ai di gjithçka për miqtë e mi. Meqë ra fjala, ai ka dhe patentë shoferi, kështu që mendoj se është mbi 18 vjeç.**

E kuptoj. A ka ndonjë fotografi në profilin e tij?

**Sigurisht, ai ka udhëtuar pothuajse kudo. Kontrollova nëse profili i tij ishte i rremë, relaksohu.**

Atëherë, çfarë mendon?

**Unë nuk e di. Ai duket se është në rregull ... Gjithsesi, ai i bën fotografitë, kështu që, zakonisht, nuk është në foto. Por ai ka ndjekës në Insta, dhe është edhe në Snapchat.**

Epo, nuk të bën dëm që të jesh i kujdesshëm. A keni folur në kamera?

**Jo, ai dëshiron që të jetë një takim i verbër.**

Mirë, por megjithatë, do të ishte e dobishme dhe e rëndësishme të mendoni për këtë situatë. Nëse vendos të shkosh sepse mendon se është e sigurt, të paktën tregoi dikujt ku do të takoheni, mundësisht një të rrituri, që ata ta dinë saktësisht se ku je dhe me kë je.

**Po, sigurisht. Por prindërit e mi do të frikësoheshin. Shoku im do të jetë në shtëpinë e babait të tij. Ndoshta kushëri do të ishte i përshtatshëm për këtë rast.**

Kjo tingëllon si një ide e mirë, mbase ai madje mund të rrijë vërdallë. Ku vendosët të takoheni?

**Ai do të më marrë pas orarit të notit dhe më pas do të dalim për të shkrepur disa foto. Ai ka një projekt dhe thotë se unë jam i përshtatshëm për të.**

E kuptoj këndvështrimin tënd, por...

**Cila është më e keqja që mund të ndodhë?**

Epo, ti e di që je ligjërisht përgjegjës për të vendosur nëse do që të bëni seks apo jo, por kjo nuk do të thotë që ai mund të bëjë gjithçka me ty dhe që ti nuk e dëshiron. As fotografi, asgjë!

**Dakord...**

Sidoqoftë, a nuk mendoni se do të ishte më mirë të takoheshit diku ku ka më shumë njerëz? Sapo ka dalë dhe një film i ri.

**Unë vetëm dëshiroj që kjo të funksionojë...**

Unë mendoj se duhet t'i jepni vetes pak kohë. Nëse nuk ndihesh rehat pranë tij, do të jetë shumë, shumë më e lehtë që të largohesh.

**Po, kjo është e qartë. Faleminderit! Do të mendoj për këtë. Mund të flasim nesër?**

Sigurisht.

BASHKËMOSHATARËT MBËSHTETËS JANË NXËNËS, TË CILËT MBËSHTETIN BASHKËMOSHATARËT E TYRE KUR ATA KANË PYETJE OSE PËRFSHIHEN NË TELASHE. JU MUND T'U FLISNI ATYRE NË NJË MËNYRË TË RELAKSUAR, KONFIDENCIALE DHE, NËSE ËSHTË E NEVOJSHME, ATA MUND T'JU VENDOSIN NË KONTAKT ME PERSONA TË RRITUR TË CILËT MUND T'JU NDIHMOJNË.

NËSE NJË SHOK ONLINE OSE DIKUSH NË INTERNET JU OFRON NJË TAKIM PËR TË BËRË FOTO SEKSUALE EKSPLCITE ME JU OSE PËR TË PATUR MARRËDHËNIE SEKSUALE ME JU, AI PERSON ËSHTË DUKE KRYER NJË KRIM.



**Mbështetës i bashkëmoshatarëve**



# DISA FOTO TË QARKULLUARA NË GRUPIN TONË TË BISEDËS



**RAPORTOJENI, MOS E INJORONI!**  
PËRMBAJTJA E PALIGJSHME MUND TË RAPORTOHET NË MËNYRË ANONIME NË HOTLINE-T NË INTERNET, TË CILËT MUND TA HEQIN ATË NGA INTERNETI. ATA MUND TË KËRKOJNË NGA HOSTI TË FSHIJË FOTOT NË SERVERIN QENDROR. ZGJIDHNI VENDIN TUAJ NË: [WWW.INHOPE.ORG](http://WWW.INHOPE.ORG)

**Duhet të flasim diçka për serioze.**

Përshëndetje, si po shkon?

**Shiko, është një djalë i ri në klasën tjetër.**

Po, më duket se kam dëgjuar disa gjëra rreth tij, por nuk po i jap mësim.

**Disa fëmijë filluan ta ngacmojnë atë për të provuar nëse ai është me të vërtetë po aq i keq sa ç'ka namin. Dhe, realisht, tani të gjithë po qeshin me të.**

Kjo tingëllon shumë shqetësuese. Ejani, ne mund të flasim me qetësi këtu ...Më thuaj çfarë ndodhi!

**Në fillim ishte për gallatë, por tani më duket shumë e çuditshme ajo çfarë po ndodh. Disa prej shokëve të tij krijuan një profil të rremë dhe filluan t'i shkruajnë atij se sa i lezetshëm është qeni i tij, sa të bukura janë vizatimet e tij në Insta, që ai është kaq i mirë ... gjëra të tilla si këto...**

A e menaxhuan disa njerëz këtë profil?

**Ata ishin tre në fillim, pas kësaj unë nuk kam asnjë të dhënë.**

Kuptoj.

**Ata po i shkruanin atij pa pushim, në mëngjes, mbrëmje dhe pas një kohe gjërat dolën jashtë kontrollit. Mund ta imagjinoni.**

Kështu që ai ishte tradhtuar ...

**Ky nuk është fundi i ngjarjes. Për shkak se e gjithë kjo u përhap, disa fotografi dhe mesazhe qarkulluan . Padyshim që ai nuk do të donte që dikush t'i shihte ... Edhe vëllait tim ia dërguan ato në një mesazh privat, dhe ne gjithashtu e dërguam atë në chat në grupin tonë të klasës. Kush e di kush tjetër i mori ato ...**

Unë me të vërtetë jam i kënaqur që më njoftove për këtë. Nuk është vetëm e vërtetë dhe e rrezikshme, por mund të jetë gjithashtu një akuzë penale.

**Ne nuk duam të dalim si ata që e raportuan këtë ...**

Sigurisht, kjo mbetet midis nesh. Faleminderit që më besuat. Unë do të flas me mësuesen e tij, dhe ne do të bëjmë çmos për ta zgjidhur.

**Po çfarë ndodh tani? A duhet të bëjmë më "screen-shots"?**

Nëse një imazh është në dispozicion të publikut, ai duhet të fshihet ose raportohet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe nuk duhet ta shpërndani atë më tej. A e dini si ta bëni këtë?

**Mendoj se po.**

Unë mund të të tregoj se si mund të ndihmosh edhe të tjerët me këtë. Por nëse shprehem në mënyrë të qartë në grupet tuaja të chat-it se nuk jeni dakord me këto sjellje, kjo gjithashtu mund të ndihmojë situatën.

**Ne duhet ta flasim edhe me atë djalë, por nuk dua që ai të bëjë ndonjë marrëzi ... Ose të zemërohet me ne.**

Për fat të keq, ne nuk mund ta mbrojmë atë nga dhimbja, por ne mund ta ndihmojmë dhe ta mbështesim për ta kapërcyer atë sa më lehtë. Le të mendojmë së bashku se cila do të ishte zgjidhja më e mirë për këtë problem!

**KUR DËRGOJENI FOTO TË QARTA SEKSUALE, VIDEO RRETH VETES OSE DËRGOJENI NJË MESAZH EROTIK NDAJ DIKUJIT NË TELEFONIN TUAJ CELULAR OSE NË INTERNET, QUHET 'SEXTING'. NËSE NUK JENI 18 VJEÇ, MUND TË LLOGARITET SI PAMJET PORNOGRAFIKE!**

**ABUZIMI NË INTERNET MUND TË JETË SEKSUAL OSE FYES (PËR SHEMBULL, DUKE JU BËRË PRESION TË BËNI GJËRA SEKSUALE, EDHE NËSE NUK DËSHIRONI, DUKE JU DËRGUAR FOTOGRAFI OSE DUKE JU SHFRYTËZUAR). KJO PËRFSHIN MARRJEN E TË DHËNAVE TUAJA PERSONALE KUNDËR VULLNETIT TUAJ, SHANTAZHE, PËRJASHTIM, FYERJE, NGACIM ME KOMENTE DHE SJELLJE.**

**Mësuesi**

**KUSHDO QË RUAN OSE SHPËRNDAN IMAZHE SEKSUALE TË NJË FËMIJE (QË PËRFSHIN ADOLESHENTË NËN MOSHËN 18 VJEÇ), DHE ËSHTË NË NJË MOSHË KOMPETENTE, MUND TË JETË PËRGJEGJËS PËR TË!**

**INFORMIMI I TË RRITURVE ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TË MBROJTUR FËMIJËT. NËSE ËSHTË NË INTERESIN MË TË MIRË TË FËMIJËVE TË PËRFSHIRË, DISA TË RRITURVE GJITHASHTU MUND T'U KËRROHET TË RAPORTOJNË RASTIN NË SHËRBIMET E MBROJTJES SË FËMIJËVE (KJO PËRFSHIN MËSUES, PEDIATËR OSE PROFESIONISTË QË JANË PËRGJEGJËS PËR MIRËQENIEN TUAJ).**

**NËSE I MERRNI KËTO LLOJE IMAZHESH OSE VIDEO SH NGA NJË MIK, JU NUK KENI BËRË ASGJË TË GABUAR, POR RUAJTJA E TYRE NË TELEFONIN TUAJ MUND TË JETË GJITHASHTU E DËNUESHME. JU DUHET TI FSHINI MENJËHERË DHE NUK DUHET T'I SHPËRNDANI ATO OSE T'I DËRGOJENI TEK DIKUSH TJETËR.**

**MBËSHTETINI ATA QË JANË LËNDUAR QË TË SHËROHEN SA MË SHPEJT!**

# A ËSHTË KY NJË KRIM?

NË LIGJ, IMAZHET ME SITUATA SEKSUALE OSE QË JANË SEKSUALISHT PROVOKUESE OSE QË TREGOJNË ORGANET GJENITALE TË NJË FËMIJË NËN MOSHËN 18 VJEÇ KONSIDEROHEN PORNOGRAFI ME FËMIJË.

KUSHDO QË BËN, RUAN, VË NË DISPOZICION, SHPËRNDAN OSE ME VETËDIJE VIZITON VENDE PËR TË PARË KËTO LLOJE TË FOTOGRAFISH OSE VIDEOESH MUND TË DËNOHET. LIGJI MBRON FËMIJËT NËN 18 VJEÇ NGA PUBLIKIMI I FOTOVE DHE VIDEOVE SEKSUALE TË TYRE.

MOSHA E PËRGJEGJËSISË PENALE VARET NGA VENDI JUAJ, ËSHTË E MUNDUR TË JETË PENALISHT PËRGJEGJËS EDHE NË QOFTË SE JENI NËN 18 VJEÇ. MOSHA MINIMALE E PËRGJEGJËSISË PENALE ËSHTË 14 VJEÇ NË HUNGARI, GJERMANI, DHE FEDERATËN RUSE, POR KJO MDRYSHON NGA SHTETI: AJO ËSHTË 13 NË FRANCË DHE GREQI, 12 NË BELGIKË, HOLANDË DHE TURQI, DHE 10 NË MBRETËRINË E BASHKUAR DHE ZVICËR.



## Përhëndetje, unë kam një pyetje

Si mund t'ju ndihmoj?

**Një shoqe e imja sapo ka lënë të dashurin e saj, dhe ai tani është duke i bërë shantazh duke thënë se do të postojë fotografi të saj në disa vende. Unë jam vetëm kurioze se çfarë ndodh nëse ai e bën atë dhe çfarë mund të ndodhë?**

How old is your friend?

17

Do të më ndihmoje duke me thënë se për çfarë lloj ftoresh po flasim këtu?

**Ka disa foto lakuriq ose gati lakuriq dhe gjithashtu disa foto shumë seksi.**

Është shumë e rëndësishme që na ke shkruar, sepse ligjet janë mjaft strikte për shpërndarjen e fotove lakuriq apo gjysmë-lakuriq të njerëzve nën moshën 18 vjeç.



Çdokush që poston, shpërndan ose transmeton fotografi ose video të tilla për të tjerët mund të ndiqet penalisht.

Ish i dashuri i shoqës tuaj mund të dënohet për krijimin, ruajtjen ose publikimin e këtyre fotove, edhe nëse ai është nën moshën 18 vjeç.

**Edhe në qoftë se ajo kishte rënë dakord që i dashuri i saj mund ti bënte ato fotografi? Ose nëse ajo i kishte dërguar vetë ato foto?**

Edhe nëse ajo i ka dërguar ato fotografi, apo edhe nëse janë marrë me pëlqimin e saj.

**Prandaj, nuk paska rëndësi se kush i kishte fotot?**

Po, sepse të ruash dhe të marrësh fotografi të tilla është e dënueshme me ligj.

**Kështu që është e dënueshme, edhe nëse ai i mban ato vetëm në telefonin e tij?**

Po. Në fakt, procedura ligjore mund të iniciohet kundër kujtdo që merr një foto të tillë, por dhe kur në vend të fshirjes e ruan fotografinë apo e ndan me të tjerë.

**Edhe në qoftë se kjo fotografia është e saj dhe e mban vetëm ajo ??**

Zakonisht vetëm nëse foto është e dikujt tjetër.



**Pra, nëse kjo histori bëhet publike shoqja ime nuk do të jetë në telashe? 🙄**

Ajo nuk do të jetë në telashe, por ish i dashuri i saj dhe çdo tjetër mund të dënohet në qoftë se ata postojnë fotografinë.

**Si mund ta raportosh atë? A duhet ta dinë prindërit për këtë?**

Fëmijët mund të raportojnë, me prindërit e tyre ose dhe pa ta.

NË DISA VENDE, FËMIJËT JANË TË LEJUAR PËR TË BËRË APO RUAJTUR FOTOGRAFI TË TRUPIT TË TYRE, ME KUSHT QË ATA TË JENË NË MOSHË LIGJORE PËR TË DHËNË PËLQIM PËR MARRËDHËNIE SEKSUALE.

SA HERË QË AUTORITETET KUPTOJNË PËR NJË SHKELJE TË MUNDSHME, GJITHMONË DUHET TË HETOJNË PËR RASTIN. POLICIA E HETON ATË EDHE NË QOFTË SE PERSONI QË KA PUBLIKUAR FOTOT ËSHTË NË NJË SHTET TJETËR. SHËRBIMET E MBROJTJES SË FËMIJËVE NJOFTOHEN PO ASHTU PËR ANKESAT. NËSE JU PROVONI PËR TË RAPORTUAR DIÇKA DHE POLICIA NUK E MERR SERIOZISHT, JU MUND TË TELEFONONI LINJËN NDIMHËSE TË FËMIJËVE. PËR TË RAPORTUAR NJË FOTO, ZGJIDHNI VENDIN TUAJ NË: [WWW.INHOPE.ORG](http://WWW.INHOPE.ORG)

Mesazh



PRIVATËSIA JUAJ DHE TË DHËNAT TUAJA PERSONALE DUHET TË JENË TË MBROJTURA.

**Do ti shohë policia fotografinë?**

Kur procedurat ligjore kanë filluar, hetuesit duhet të identifikojnë viktimat, kështu që normalisht ata do të shohin pamjet. Fotografitë regjistrohen si dëshmi, por njerëzit që mund të shohin provat janë të pakët.

**Çfarë ndodh nëse ish i dashuri i saj arrestohet?**

Autoritetet marrin parasysh seriozitetin dhe rrethanat e krimit. Qëllimi është gjithmonë që pasojat janë efektive, proporcionale dhe bindëse. Çfarëdo që autoritetet të vendosin, është përgjegjësi e tij dhe jo faji i shoqës tuaj.

**Përgjegjësi, si?**

Dënim, gjobë, por ai gjithashtu mund të përjashtohet, për shëmbull nga një program edukativ.

**Pra, si mund të bëhet fshirja e fotove nga ai?**

Autoriteti mund ta detyrojë atë të që të heqë fotot, por duke folur me personin që ka fotot mund ta ndihmohet të kuptojë pasojat e asaj që ai është duke bërë.

**Në rregull, e kuptova, faleminderit!! 🙄**

Nëse keni ndonjë pyetje tjetër mos ngurroni të kontaktoni me mua!



# KUR FILLON NDJEKJA PENALE

NDONJËHERË SEANCA MUND TË KRYET VETË NGA NJË PSIKOLOG. DISA SHTETE SIGUROJNË QË PERSONI QË MERR NË PYETJE ËSHTË GJITHMONË NJË PERSON I GJINISË SË NJËJË NË RAST SE INTERVISTOHENI PËR VEPRA SEKSUALE. NËSE JU NUK E FLISNI GJUHËN, JU DUHET GJITHMONË TË KENI NJË PËRKTHYES ME VETE. FLISNI ME AVOKATIN TUAJ OSE AUTORITETET DHE ATA DUHET TA ORGANIZOJNË KËTË GJË.



SIGURIA JUAJ ËSHTË GJITHMONË PRIMARE. AUTORITETET DUHET T'JU MBROJNË KUNDËR FRIKËSIMIT, HAKMARRJES DHE VIKTIMIZIMIT TË PËRSËRITUR. NË QOFTË SE JU NDIHENI TË PAREHATSHËM OSE TË FRIKËSUAR, BISEDONI ME TË RRITURIT QË JANË DUKE JU NDIHMUAR ME PROCEDURËN.

PRIVATËSIA JUAJ KA NEVOJË TË JETË E MBROJTUR. EDHE NË QOFTË SE ATA FLASIN PËR ATË QË KA NDODHUR NË TV OSE NË RADIO, EMRI JUAJ DHE FYTYRA DUHET TË JETË E FSHEHUR NGA PUBLIKU DHE ÇDO DETAJE QË MUND TË ÇOJË NË IDENTIFIKIMIN TUAJ.

(...) Tani që ne jemi këtu për të njohur njëri-tjetrin, më lejoni t'ju them pak se çfarë duhet të prisni gjatë procedurës. Unë do të përpiqem të jem i qartë, por nëse diçka është e paqartë, ju lutem, mos ngurroni të pyesni!

**(Fëmija) Mirë.**

**(Prind) Faleminderit.**

Mbrojtja juaj është jetike gjatë hetimit dhe marrjes së vendimit. Të drejtat dhe interesat tuaja më të mira gjithmonë duhet të respektohen.

**(P) Për çfarë duhet të jemi të përgatitur?**

Qëllimi i hetimit është për të gjetur se çfarë ka ndodhur. Gjatë hetimit mblidhen prova ose dëshmi që do të gjykohen nga gjykata. Ju do të jeni të fuar për të shkuar në seancë. Çfarë do thoni aty – ajo është dëshmia juaj - mund të përdoret si provë apo dëshmi në gjykatë, përveçse nëse ju e tërhiqni më vonë.

**(F) A duhet të them gjithçka?**

Ju ndihmoni hetimet duke folur me ndershmeri. Kjo është detyra juaj. Në qoftë se është absolutisht e nevojshme, gjykatësi apo autoritete të tjera mund të kenë nevojë të bëjnë pyetje më të detajuara.

**(P) Eshtë absolutisht e nevojshme që të dëshmojë edhe djali im?**

Djali juaj mund të duhet të dëshmojë nëse policia nuk mund të marrë prova në formë tjetër, ose nëse djali juaj dëshiron vetë të dëshmojë, ai do të dëgjohet.

**(P) Ku duhet të shkojmë?**

Ju do të merrni një letër që do të deklarojë emrin dhe adresën e autoritetit. Në disa raste, djali mund të mos kërkohet të shkojë në seancë personalisht, por për të bërë një telefonatë video online.

**(P) Nuk është e lehtë për të që të flasë për ngjarjen. A është e mjaftueshme nëse e rrëfen vetëm një herë?**

Policia duhet të shmangë përsëritjen e intervistave, kështu që djali nuk do të duhet të flasë përsëri për atë çështje. Per këte arsye, intervistat mund të filmohen që të mund të përdoren si dëshmi në gjykatë. Por ai prapë mund të thirret për të folur për ngjarjen dhe herë të tjera.

**(F) A mundet mami të vijë me mua?**

Po. Për sa kohë që ju nuk jeni 18 vjeç, prindi ose përfaqësuesi ligjor duhet të jetë i pranishëm. Ndonjëherë ju mund të zgjidhni vetë të rriturin që ju doni t'ju shoqërojë.

**(F) Kush tjetër do të jetë atje?**

Një polic i cili bën pyetje, por ju gjithashtu mund të kërkoni dhe një psikolog. Si avokati juaj, mund të jem dhe unë i pranishëm.

**(F) A do të jetë ai që e ka filluar gjithë këtë gjë atje?**

Do të tregohet kujdes që ju mos të takoheni me personin që ju ka lënduar. Kjo ndodh gjithmonë, me përjashtim të rasteve kur ky veprim nuk është në interesin tuaj më të mirë dhe është diskutuar më parë me ju.

**(P) Me aq sa di unë gazeta ka pyetur në lidhje me incidentin...**

Në rastin e një vepre seksuale, shtypi nuk mund të marrë pjesë në gjykim. Dhe publiku mund të përjashtohet në çdo kohë sipas kërkesës. Seancat kanë qenë gjithmonë të mbyllura. Shtypi nuk mund të bëjë asgjë publike që do ta bënte të mundur identifikimin tuaj.

**(P) A mund ti drejtohem dikujt për ndihmë?**

Nëse ju dëshironi, djali juaj mund të bisedojë me profesionistë të cilët do ta ndihmojnë për të lehtësuar dhimbjen nga procedurat dhe krimi që ka ndodhur. Natyrisht, ndihma juridike mund të jetë në dispozicion, si dhe mundësia për të kërkuar ndihmë nga grupet e jashtme, fondacionet dhe shoqatat.

JU DO TË MERRNI TË GJITHA INFORMACIONET QË DO JU NDIHMOJNË TË KUPTONI TË DREJTAT TUAJA DHE ÇFARË NDIHME ËSHTË NË DISPOZICION PËR JU. ËSHTË E RËNDËSISHME QË JU TË KUPTONI PROCESIN, ROLIN TUAJ SI DHE ZHVILLIMET, REZULTATET DHE KOSTOT E RASTIT TUAJ.

JU KENI TË DREJTË PËR NJË GJYKIM TË DREJTË. AUTORITETI DUHET T'JU SIGUROJË QË JU TË MOS DËMTOHENI GJATË GJYKIMIT DHE QË JU TË MERRNI TË GJITHË NDIHMËN QË JU NEVOJITET. PROCEDURAT NUK DUHET TË VONOHEN, POR PËR FAT TË KEQ, ATO MUND TË ZGJASIN MUAJ APO VITE.

PIKËPAMJET TUAJA JANË TË RËNDËSISHME DHE GJITHMONË DUHET TË DËGJOHEN DHE TË MERRREN NË KONSIDERATË. NËSE JU DËSHIRONI, JU MUND TË SHPREHNI PIKËPAMJET TUAJA NËPËRMJET NJË NDËRMJETËSI - SI PRINDËRIT OSE AVOKATI.

NËSE ËSHTË E MUNDUR, INTERVISTAT ME FËMIJË MBAHEN NË DHOMA TË PROJEKTUARA DHE TË PËRSHTATURA PËR KËTË ARSYE. PYETNI POLICËT APO AVOKATIN TUAJ NËSE KJO MUND TË ORGANIZOHET DHE PËR JU.



Avokati

NË RAST SE PRINDËRIT TUAJ OSE PËRFAQËSUESI LIGJOR JU KA LËNDUAR APO ABUZUAR DHE INTERESAT TUAJA JANË NË RREZIK, NJË PËRFAQËSUES SPECIAL ('KUJDESTAR AD LITEM') DO TË CAKTOHET PËR T'JU NDIHMUAR DHE PËR TË MBROJTUR TË DREJTAT TUAJA KËSHTU QË JU NUK DO TË VARENI NGA PERSONIN QË JU KA ABUZUAR.

# ËSHTË DETYRA E SHTETIT PËR T'JU MBROJTUR

Askush nuk lejohet t'ju dëmtojë ose shfrytëzojë. Trupi juaj ju përket juve. Askush nuk mund të bëjë asgjë me trupin tuaj nëse ju nuk dëshironi. Po ashtu, askush nuk mund të luajë me ndjenjat tuaja duke ju bërë presion. Shteti ka premtuar të bëjë çmos për t'ju mbrojtur.

## Ku e premtoi shteti?

Një kongres ndërkombëtar u mbajt përpara Këshillit të Evropës, në 2007, në ishullin Lanzarote, Spanjë. Quhet Konventa e Lanzarote-s.

## Cilat vende janë të përfshira?

Pothuajse të gjitha vendet në kontinentin Evropian janë pajtuar me Konventën e Lanzarote-s për të mbrojtur të drejtat tuaja.

## Për çfarë shërben kjo Konventë?

Ndalon shfrytëzimin seksual dhe abuzimin e fëmijëve. Kushdo që lëndon një fëmijë kryen një krim. Qëllimi i Konventës është të parandalojë që kjo të mos ndodhë, të mbrojë ata që janë lënduar dhe t'i mbajë përgjegjës njerëzit që i lëndojnë.

## Si mund të arrihet ky qëllim nga shteti?

Është detyrë e shtetit t'ju informojë për të drejtat tuaja, në mënyrë që të mund të dalloni abuzimin, të mësoni për edukimin seksual dhe seksualitetin dhe të dini se kujt mund t'i drejtoheni. Shteti duhet të bëjë hapa për të siguruar që profesionistë që punojnë me fëmijë janë të përgatitur mirë dhe që punojnë për interesat tuaja më të mira. Ata gjithashtu duhet të hetojnë dhe ndjekin penalisht personat që kryejnë këto krime dhe të bashkëpunojnë me shtete të tjera.

## A kontrollon dikush nëse vërtet shteti e mban premtimin e vet?

Komiteti i Lanzarote monitoron këtë aspekt. Shtron pyetje për shtetet, që duhet të marrin përgjigje. Komiteti gjithashtu është i interesuar për mendimet e shoqërisë civile dhe të fëmijëve.

## Çfarë është Këshilli i Evropës?

Këshilli i Evropës ka 47 shtete anëtare nga i gjithë kontinenti i Evropës. Që nga viti 1949, kërkon të promovojë demokracinë dhe të mbrojë të drejtat e njeriut.



Konventa e Lanzarote



Opinionet e shprehura në këtë punë janë përgjegjësi e autorit (ëve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

Titulli original: So, this is sexual abuse?

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose transmetohet, në çfarëdo forme ose me çfarëdo mjeti, elektronik (CD-Rom, Internet, etj) ose mekanik, duke përfshirë fotokopjimin, regjistrimin ose cilindo sistem ruajtjeje ose rikuperimi të informacionit, pa lejen paraprake me shkrim nga Drejtoria e Komunikimit (F-67075 Strasbourg Cedex ose [publishing@coe.int](mailto:publishing@coe.int)).

Redaktor: Barbara Németh, Fondacioni për të Drejtat e Fëmijëve Hintalovon (Hintalovon Child Rights Foundation)

Ilustrimi: Tímea Medvegy, Hintalovon Child Rights Foundation

Sipas Aktit Nr. 76 të vitit 2017 Fondacioni Hintalovon është një organizatë jo-qeveritare e financuar nga jashtë.

Botimi i Këshillit të Evropës F-67075 Strasbourg Cedex <http://book.coe.int>

© Këshilli i Evropës, Nëntor, 2019

Këshilli i Evropës falënderon për mbështetjen financiare të dhënë për këtë program nga *Fondi për dhunën ndaj fëmijëve*.

Titulli në perktimin shqip: Pra, ky qënka abuzimi seksual?

Teksti origjinar nga dhe përdorur me lejen e Këshillit të Evropës. Ky përkthim është botuar me marrëveshje me Këshillin e Evropës, por nën përgjegjësinë e vetme të përkthyesit.

© Terre des hommes, Janar, 2020 Perktimi shqip  
Printimi: Terre des hommes

Perkthyes: Vullnetare te Terre des hommes

Kjo broshurë u prodhua në partneritet me fëmijët, me ndihmë të Fondacionit Hintalovon për të Drejtat e Fëmijëve (Hintalovon Child Rights Foundation).

Fëmijët dhanë një kontribut të vlefshëm për të vendosur se çfarë do të përfshihet dhe si do të shpjegohet për ju.

**MUND TË GJENI MË SHUMË KËTU:**

[www.coe.int/children](http://www.coe.int/children)

**NA DËRGONI ME EMAIL MENDIMET TUAJA:**

[lanzarote.committee@coe.int](mailto:lanzarote.committee@coe.int)



**Terre des hommes**  
Helping children worldwide

SQL



**End Violence  
Against Children**  
THE FUND

